

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6803
E hënë, 16 janar 2023
çmimi 0.40

Lufta s'ka përfunduar, por si të fitojmë sërish?

FAQE 8

Nga Burim
RAMADANI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" HISTORIANI HAKIF BAJRAMI | FAQE 4-5

LULËKUQJA TË BËHET ME LIGJ SIMBOL I GJENOCIDIT NË KOSOVË

- Lulëkuqja është simbol i lirisë, produkt i gjakut dhe i luftës së drejtë të UÇK-së



Profesori i njohur i historisë, Hakif Bajrami, i ka dhënë mbështetje kërkesës që lulëkuqja të njihet si simbol i gjenocidit në Kosovë. Ai ka thënë se kjo iniciativë duhet të materializohet me ligj nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë intervistë për "Epokën e re",

Bajrami ka thënë se lulëkuqja është simbol i lirisë dhe i luftës së drejtë të UÇK-së. "Ky simbol nuk e akuzon askënd sepse është një lule e bukur e natyrës", ka thënë Bajrami. Kur Kosova shënon Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit, Bajrami ka thënë se institucionet e

vendit nuk kanë qenë në nivel të detyrës. Bajrami ka thënë se Serbia duhet të përgjigjet për 14 mijë shqiptarët e vrarë në luftën e fundit, për 20 mijë femrat e dhunuara, për rrënimin e 120 mijë shtëpive dhe për 600 varrezat masive

MASAKRA E REÇAKUT "I TREGOI BOTËS TRAGJEDINË QË PËRJETUAN SHQIPTARËT"

FAQE 3



QENDRA "GJENOCIDI NË
KOSOVË - PLAGË E HAPUR"
BËRI HOMAZHE TE KOMPLEKSI
PËRKUJTIMOR NË REÇAK

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE




25 VIKTIMA NGA SULMET RUSE NË
DNJIPRO F.2

WILLIAMWALKER NDEROHET ME
TITULLIN "DOCTOR HONORIS
CAUSA" NGA UNIVERSITETI
"HAXHI ZEKA" F.3

"FLAKA E JANARIT" NISI SI
FORMË REZISTENCE NDAJ
PUSHTUESIT F.6



EKONOMI



MAQEDONI E VERIUT,
PAGË MINIMALE PËR SHPENZIME
MAKSIMALE F.8

PRITET TË HAPEN 300 VENDE TË
REJA TË PUNËS F.8

SPORT



BASHKIMI TRIUMFON NDAJ
RAHOVECIT, PEJA I KTHEHET
FITOREVE F.11

Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” bëri homazhe te Kompleksi Përkujtimor në Reçak

SHTIME, 15 JANAR - Në Ditën e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit, një delegacion i Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka bërë homazhe te Kompleksi Përkujtimor në Reçak, aty ku prehen eshtrat e 45 civilëve shqiptarë të vrarë nga forcat serbe në aktin gjenocidar më 15 janar 1999.

Ky delegacion përbëhet nga kryetari i Qendrës, Bardhyl Mahmuti, zëvendëskryetari Adnan Asllani, drejtuesi i Qendrës në Kosovë, Bujar Dugolli, anëtarja e kryesisë, Shqipe Bytyqi, profesorë universitarë, kryetari i

Fondacionit “Hasan Prishtina”, Mehmet Prishtina dhe anëtarë të tjerë të Qendrës.

Përveç homazheve që bënë te varrezat e viktimave të gjenocidit, delegacioni vendosi lule të freskëta në këtë memorial për ta përçuar mesazhin se dhembja jonë për këtë tragjedi kombëtare, si dhe për të gjitha viktimat e krimit të gjenocidit, është e madhe dhe plagët tona janë të hapura.

Ndërkohë veprimtarët e Qendrës në komunën e Shtimes i pajisën me simbolin e lulëkuqes vizitorët që kishin ardhur për të bërë homazhe në Reçak.



25 viktima nga sulmet ruse në Dnjipro

DNJIPRO, 15 JANAR - Numri i personave të vdekur nga sulmet me raketa ruse në qytetin ukrainas Dnjipro ka shkuar në 25, ka njoftuar këshilli i qytetit. Sipas tij, 72 persona janë plagosur si pasojë e sulmeve, të cilat janë shtrirë edhe në qytete të tjera. Sipas të dhënave, 39 persona, përfshirë gjashtë fëmijë, janë shpëtuar.

Më herët gjatë ditës këshilli ka shpallur tri ditë zie për atë që e ka përshkruar “sulmin më të rëndë terrorist në Dnjipro” prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë.

Ekipet e shpëtimit kanë përdorur një kran për t'i evakuuar personat e bllokuar në katet e sipërme të ndërtesës nëntëkatëshe.

Ushtria ukrainase beson se ndërtesa është goditur me raketë me rreze të gjatë, Kh-22. Si



rezultat, hyrja e ndërtesës është shkatërruar plotësisht.

Sipas ushtrisë, vetëm më 14 janar

Rusia ka kryer tri valë të sulmeve në qytetet ukrainase.

Për sulmet është raportuar në

ditën kur kryeministri britanik, Rishi Sunak, ka thënë se Mbretëria e Bashkuar do të

dërgojë tanke në Ukrainë, për t'u ndihmuar forcave ukrainase që t'i “zmbarsin forcat ruse”. Sunak e ka bërë këtë zotim duke përmendur tanket Challenger 2 dhe sisteme shtesë të artilerisë. Sipas tij, kjo është shenjë e “ambicieve të Mbretërisë së Bashkuar për ta rritur mbështetjen për Ukrainën”.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Përndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

OBSh-ja i kërkon Kinës më shumë informata për situatën me koronavirus

Gjenevë, 15 janar - Organizata Botërore e Shëndetësisë i ka bërë thirrje Kinës që të bëjë publike më shumë informacione për valën e koronavirusit pasi qeveria kineze ka thënë se rreth 60 000 persona kanë vdekur brenda një muaji me këtë virus. Një njoftim i tillë i autoriteteve kineze shënon herën e parë që Partia Komuniste bën të ditura shifrat e viktimave prej heqjes së disa kufizimeve për pandeminë në dhjetor të vitit të kaluar.

Qeveria ka thënë se 5 503 persona kanë vdekur si pasojë e dështimit të organeve të frymëmarrjes nga koronavirusi dhe 54 435 të tjerë kanë pasur kancer, sëmundje të zemrës dhe komplikime të tjera, përveç Covid-19, sëmundjes që shkakton koronavirusi.

Kjo shifër u referohet vetëm vdekjeve të regjistruara në qendrat mjekësore, andaj besohet se situata reale është më e rëndë.

Shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se informacione të tilla të detajuara duhen publikuar edhe në të ardhmen, pasi “krijojnë ide më të mirë për situatën epidemiologjike”.

Zyrtarët shëndetësorë kinezë kanë thënë me raste se “nuk është e domosdoshme” që të publikohen shifrat e sakta. Më parë Pekini pati ndryshuar metodologjinë e raportimit të vdekjeve me koronavirus, duke thënë se do t'i regjistrojë vetëm personat që vdesin nga sëmundjet e frymëmarrjes.



Mirëpo diçka e tillë është kritikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë e cila ka thënë se definicioni i ri “është

shumë i ngushtë”.

Zyrtarët shëndetësorë kinezë kanë thënë të shtunën se moshat mesatare e viktimave ka qenë

80.3 vjet dhe se 90 për qind e të vdekurve janë mbi moshën 65-vjeçare.

Sipas tyre, shumica kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Aktualisht, miliona persona mbi moshën 60-vjeçare janë të pavaksinuar në Kinë.

Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020.

Më shumë se 6.7 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

Masakra e Reçakut “i tregoi botës tragjedinë që përjetuan shqiptarët”

Me rastin e 24-vjetorit të masakrës së Reçakut, presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë homazhe në Memorialin Përkujtimor në Reçak. I pranishëm në këtë përvjetor ka qenë edhe ish-ambasadori amerikan William Walker, i cili gjatë vitit 1999 ka shërbyer si shef i OSBE-së në Kosovë dhe ka dokumentuar krimet e kryera në këtë fshat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

REÇAK, 15 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se viktimat e Reçakut i kanë treguar botës për tragjedinë që e kanë përjetuar shqiptarët më 1999.

Ajo e ka bërë këtë deklaratë në një ceremoni përkujtimore që është mbajtur të dielën në Shtime në 24-vjetorin e masakrës së Reçakut.

Më 15 janar të vitit 1999, në fshatin Reçak, rreth 30 kilometra larg Prishtinës, forcat serbe kanë vrarë 45 civilë shqiptarë. “Masakra e Reçakut bëri që qendrat vendimmarrëse, demokratike, të mobilizoheshin për ta mbrojtur një popull që po vuante nën

kthetrat e një regjimi gjenocidal. Por, edhe për të dëshmuar se qytetërimi perëndimor nuk mund të dorëzohej para hegjemonive, prandaj Kosova duhej të ndihmohej e të mbrohej”.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se, po ashtu, masakra e Reçakut ka nxitur më së shumti ndryshime të qëndrimeve të shteteve të huaja për “atë që po bënte Serbia në Kosovë”. “Teksa kujtojmë dhe nderojmë të gjitha viktimat e të vdekurve dhe të gjallëve të asaj kohe të errët, më lejoni që para jush, nga pozita e kryeministrit, t’ju them që shteti ynë demokratik nuk i amnistion kriminelët dhe nuk i harron krimet e luftës”.

I pranishëm në këtë ceremoni ka



qenë edhe ish-ambasadori amerikan William Walker, i cili gjatë vitit 1999 ka shërbyer si shef i Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë dhe ka

dokumentuar krimet e kryera në këtë fshat.

Ngjarja e Reçakut është pasuar nga bombardimet e NATO-s mbi caqet serbe në Kosovë dhe Serbi. “Duke cilësuar masakrën e Reçakut si krim kundër njerëzimit dhe duke kërkuar drejtësi për viktimat, ambasadori Walker u shndërrua në zërin e viktimave dhe në zërin e gjithë Kosovës në kohët më të rënda në historinë tonë”, ka thënë Osmani teksa ka vlerësuar rolin e Walkerit në raportimin për masakrën.

Vetë Walker ka thënë në ceremoni se në Reçak është kthyer edhe në rreth 15 përvjetorë të tjerë për t’i parë sërish banorët e fshatit. “Më pëlqen kur shoh fëmijë, shumë fëmijë. Këtë vit, kur kemi ecur afër varrezave, nuk kam mundur të dalloj se kush janë familjarët e viktimave dhe kush kanë qenë njerëzit që kanë dashur të vijnë për nderim, sepse çdo vit shtohet numri i njerëzve që duan të tregojnë respekt për atë që përfaqëson Reçaku”.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se epilogo i asaj dite të kobshme

ishte: 45 civilë shqiptarë të vrarë e të masakruar, prej tyre edhe fëmijë e pleq. “Të gjithë civilë të paarmatosur. Askush në Serbi nuk është dënua për krimin makabër të kryer në Reçak. Masakra e Reçakut, që tmerroi botën demokratike dhe nxiti intervenimin e NATO-s, dëshmoi projektin gjenocidal të Serbisë ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare në Kosovë”, ka theksuar Konjufca

Në paraditen e së dielës krerë shtetërorë dhe qindra qytetarë kanë kryer homazhe te memoriali që nderon viktimat e kësaj masakre në Reçak. Në mesin e tyre ka qenë edhe ambasadori francez në Kosovë, Olivier Guerot.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe njihet nga mbi 100 vende të botës. Serbia nuk e njeh pavarësinë e saj dhe në Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë atë pjesë të territorit të saj.



William Walker nderohet me titullin “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti “Haxhi Zeka”

PEJË, 15 JANAR - Ish-shefi i misionit të OSBE-së gjatë luftës në Kosovë, ambasadori William Walker, në një ceremoni solemne u nderua me titullin “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti Publik “Haxhi Zeka” në Pejë.

Ky titull iu akordua me motivacionin “Për humanizëm dhe guxim të veçantë njerëzor dhe profesional në mbajtjen dhe avancimin e vlerave themelore, të drejtave të njeriut drejt unifikimit të botës demokratike në ruajtjen e vlerave jetike për njerëzimin”.

Miku i madh i Kosovës luajti një rol të pazëvendësueshëm për unifikimin e vendeve demokratike të botës, për reagimin e tyre në ndaljen e akteve çnjerëzore serbe mbi popullatën civile shqiptare në Kosovë në vitin 1999. “Shteti ynë është me fat që ka miq të tillë, ndërsa Universiteti “Haxhi Zeka” e ka për nder e krenari dhënien e çmimit më të lartë të tij personaliteteve të tilla si ambasadori William Walker”, u tha në ndarjen e këtij titulli.





FLET PËR "EPOKËN E RE" HISTORIANI HAKIF BAJRAMI

Lulëkuqja të bëhet me ligj simbol i gjenocidit në Kosovë

- Lulëkuqja është simbol i lirisë, produkt i gjakut dhe i luftës së drejtë të UÇK-së

Profesori i njohur i historisë, Hakif Bajrami, i ka dhënë mbështetje kërkesës që lulëkuqja të njihet si simbol i gjenocidit në Kosovë. Ai ka thënë se kjo iniciativë duhet të materializohet me ligj nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Bajrami ka thënë se lulëkuqja është simbol i lirisë dhe i luftës së drejtë të UÇK-së. "Ky simbol nuk e akuzon askënd sepse është një lule e bukur e natyrës", ka thënë Bajrami. Kur Kosova shënon Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit, Bajrami ka thënë se institucionet e vendit nuk kanë qenë në nivel të detyrës. Bajrami ka thënë se Serbia duhet të përgjigjet për 14 mijë shqiptarët e vrarë në luftën e fundit, për 20 mijë femrat e dhunuara, për rrënimin e 120 mijë shtëpive dhe për 600 varrezat masive

Bardhlyt, sepse kam korrespondencë më të, dhe ai e kishte botuar qëndrimin tim në mbështetje të lulëkuqes. Pavarësisht kësaj, mendoj se kjo qasje nuk është bash e lehtë, pra është shumë e komplikuar, sepse duhet të bëhet ligji mbi gjenocidin ndaj shqiptarëve. Atë ligj duhet ta debatojnë komisionet shkencore e pastaj ato parlamentare dhe të dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Qeveria nuk duhet të merret me këtë çështje sepse qeveria nuk bën ligje. Ai ligj nuk duhet të jetë i gjatë, por duhet të jetë shumë i shkurtër, me 4-5 nene taksative dhe kjo çështje të përfundojë me aprovimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

"Epoka e re": A e përkrahni një iniciativë të tillë dhe a duhet të njëjtën gjë ta bëjnë edhe institucionet e Kosovës?

Bajrami: Fillimisht kjo

iniciativë duhet të dërgohet në Kuvendin e Kosovës dhe kur ta aprovojë Kuvendi ajo del në gazetën zyrtare ku nënshkruhet nga presidentja dhe në këtë mënyrë bëhet dokument shtetëror obligativ. Simbolika e lulëkuqes me rrotë të kuqe e vitit 1916 nuk ka të bëjë me ne sepse atë e kanë pasur edhe romakët. Por, lulëkuqja me katër petale është simbol se liria e Kosovës është produkt i gjakut dhe luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E tash këtu, një pjesë e partive politike janë duke hezituar.

"Epoka e re": Çfarë shpjegimi keni nga këndvështrimi juaj për lulëkuqen me katër petale?

Bajrami: Lulëkuqja simbolizon gjakun, simbolizon një lloj shëndetësie popullore, simbolizon një ardhmëri të popullit me plot besim dhe dituri. Në këtë gjenocid do ta formalizojmë si ligj dhe për Serbinë menjëherë fillon një

epokë tjetër. Me fjalë të tjera, Serbia duhet t'i paguajë reparacionet ose dëmet e luftës. Pa i paguar populli serb dëmet e luftës nuk mund ta arrijë katarzën. Unë kam biseduar me fëmijët gjermanë, ku çdonjërin prej tyre që e kam pyetur se a ka gabuar Hitleri në Luftën e Dytë Botërore më ka thënë "Po". I kam pyetur edhe fëmijët serbë se a ka gabuar Millosheviqi në luftën 89-99 në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë. Përgjigja e tyre ka qenë "Jo". Kjo përgjigje tregon se prindërit e tyre, po iu dha shansi, prapë ia mësyjnë Kosovës. Tash është edhe një fakt tjetër, që ushtria jonë është nën mbikëqyrje sepse në atë minutë që Serbia e kupton se Kosova ka ushtri ofensive, jep selam në të dy krahët.

"Epoka e re": A besoni se iniciativa e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", që lulëkuqja me katër petale të

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 13 JANAR -

"Epoka e re": Si e vlerësoni iniciativën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" që lulëkuqja me katër petale të njihet si simbol i gjenocidit në Kosovë?

Bajrami: Në vitin 2016, kur Ramush Haradinaj ka qenë

kryeministër i Kosovës, kam pas punuar ta bëj një simbolikë për gjenocidin, ku në qendër të vëmendjes është Bllaca. Në atë kohë e pata shkruar edhe aratimin për këtë simbolik. Në bazë të asaj që e kam parë në shkrime më ka pëlqyer shumë iniciativa e Bardhyl Mahmutit që lulëkuqja të jetë një simbol i gjenocidit ndaj shqiptarëve. Pas kësaj i kam shkruar

njihet si simbol i gjenocidit në Kosovë, të hasë në rezistencën e faktorit ndërkombëtar?

Bajrami: Nuk besoj sepse lulëkuqja nuk e prek askënd. Bardhyl Mahmuti është një intelektual shumë i informuar, i cili e ka deklasuar Dick Martyn. Po ashtu, ai e ka edhe librin “Eskadronët e vdekjes” etj. Bardhlyli jeton dhe vepron në vendin (Zvicër) ku vlon uji në akull. Është fakt se ne jemi më të informuar në disa probleme profesionale, mirëpo ai simbol (lulëkuqja) nuk akuzon askënd, përkundrazi fton që ne shqiptarët të mos sillemi ndaj të tjerëve qysh janë sjell serbët ndaj neve.

“Epoka e re”: *Më 15 janar shënohet Dita e Përkujtimit të Gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë. Ka më shumë se 40 vjet që keni shkruar e dokumentuar për gjenocidin që Serbia ka kryer mbi shqiptarët. Çfarë nënkupton kjo ditë për ju?*

Bajrami: Ne i kemi kampet e përqendrimit në Bllacë, Stankovec, Çegran dhe Kukës, po flas për luftën e fundit. Po ta merrni doktoratën time të vitit 1979, e cila është dorëzuar në vitin 1978, atje janë katër kampe të përqendrimit për

shqiptarët të cilat i ka formuar pikërisht kjo Serbi gjenocidale. Pra janë kampet e përqendrimit në Nish, Leskovc, Nikshiq dhe Çaçak. A i ke edhe në luftën e fundit katër kampe? Po! Këta kanë punuar me program për ta shfarosur popullin shqiptar qysh i kanë shfarosur mbi 714 fshatra dhe 6 qytete në Sanxhakun e Nishit në vitin 1877. Nuk ka popull në Evropë siç është ai serb që i ka bërë 37 programe për ta likuiduar kombin shqiptar. Pse është bërë kjo? Unë jam autor i librit të Nysret Pllanës, nuk është ai. Kur është bërë ai? Është bërë në vitin 1999 dhe më 2001 ka dalë ky libër, i cili është përkthyer në nëntë gjuhë. Po të marrësh pjesë në ndonjë promovim të ndonjë fshati ose lagjeje ku është vrarë dikush, menjëherë thonë ky shkrim është i pari edhe pse ne kemi dëshirë të shkelim mbi rezultatet e të tjerëve. Unë kurrë nuk kam shkruar ta promovoj atë libër, Nysreti e di këtë gjë. Nysret Pllana nuk ka lënë vend në botë pa e promovuar këtë libër. Mua më ka marrë në pyetje Njazi Burgideva në vitin 1979 katër pesë herë se pse i ke futur kampet e përqendrimit në

doktoraturë. I kam thënë: shko shkatërroj dokumentet arkivore të cilat e vërtetojnë këtë dhe se nuk tërhiqem kurrë - pushka top t’u bëftë! Më pat thënë t’i jap 15 vjet burgim dhe unë i pata thënë 500 jepmi sepse unë jam historian dhe nuk e shtrembëroj të vërtetën me asnjë çmim. Prandaj mua më intereson vetëm e vërteta, ndërsa sa i përket gjenocidit serb ndaj shqiptarëve, ka argumente sa të duash.

“Epoka e re”: *A kanë bërë mjaftueshëm institucionet e Kosovës, por edhe ato ndërkombëtare, që Serbia ta marrë dënimin e merituar për krimet që ka kryer në Kosovë?*

Bajrami: Nuk kanë bërë mjaftueshëm. Gjykatat tona ende janë gjykata komuniste sepse prokurori duhet t’i shtyjë çështjet përpara. Janë 600 varreza masive. Salih Mustafa është dënuar me 26 vjet burgim. Faji është edhe te Gjykata Speciale. Sa janë dënuar Nikola Shainoviqi, Vladimir Lazareviqi dhe Dragolub Ojdaniqi? Janë dënuar me nga 15 vjet burgim. Tash Gjykata Speciale po thotë se Mustafa e ka mbytur një njeri e që nuk është e vërtetë

sepse Zyra Politike e UÇK-së në Prishtinë do ta dinte. Ndërsa këta që i përmenda dhe të tjerët i kanë mbytur 14 mijë shqiptarë, i kanë dhunuar 20 mijë femra, kanë rrënuar 120 mijë shtëpi dhe i kanë krijuar 600 varreza masive. Po ashtu, i kanë bartur kufomat e të vrarëve shqiptarë nga Kosova në Serbi dhe askush nuk mban përgjegjësi. Kjo është ajo që më shqetëson sepse nuk kemi të bëjmë me një drejtësi të mirëfilltë. Askush nuk po thotë me i ndjekë serbët, por duhet të japë përgjegjësi secili që ka kryer krime. Serbia e ka të vështirë të demokratizohet. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Pavarësia e Kosovës është legjitimuar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, prandaj lulëkuqja i mbyll të gjitha plagët. Lulëkuqja është një simbol shumë i fuqishëm edhe horizontal edhe vertikal. Edhe në lartësi ky simbol është tredimensional. Ky simbol nuk e akuzon askënd sepse është një lule e bukur e natyrës.


“Epoka e re”: *Cili duhet të jetë fokusi i institucioneve të Kosovës për dokumentimin e krimeve serbe dhe a mjafton*

themelimi i Institutit për ta bërë një gjë të tillë?

Bajrami: Instituti është themeluar dhe është shuar. Prapë po thuhet se do të themelohet. Kjo është lojë me varrezat masive dhe viktimat. Është e domosdoshme që të dihet se këtu kush është agresori-xhelati dhe kush është viktimat. Natyrisht se kjo dihet dhe nuk do kallauz kjo punë. Ata që kanë punuar më herët në institut duhet t’i prezantojnë rezultatet. Instituti duhet të funksionojë me njerëz profesionistë dhe jo me dajë e teze. Pjesë e institutit duhet të jenë historianët, juristët, kriminologët dhe mjekët ligjorë. Ata duhet të punojnë së bashku me qëllim të vetëm: dokumentimin e krimeve të Serbisë ndaj shqiptarëve.

“Epoka e re”: *A besoni që në dialogun Kosovë - Serbi mund të adresohen këto çështje duke pasur parasysh se nga lufta e fundit në Kosovë ende janë të zhdukur mbi 1 600 persona?*

Bajrami: Nuk besoj se do të adresohen krimet e luftës dhe të pagjeturit derisa dialogun e udhëheqin njerëz me dy mendje dhe të cilët nxjerrin dokumente me dykuptimësi.



“Flaka e Janarit” nisi si formë rezistence ndaj pushtuesit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

GJILAN, 15 JANAR - Është mbajtur tryeza e Flakës së Janarit, në të cilën është diskutuar rreth historisë së “Flakës së Janarit” në të cilën është folur për filltet e manifestimit shumëkulturore “Flaka e Janarit”, sikurse që ka pasur edhe kumtesa rreth personaliteteve që u kushtohet ky manifestim.

Fillimisht Leonora Morina-Bunjaku, nënkryetare e komunës së Gjilanit, në emër të institucioneve komunale, ka thënë se “Flaka e Janarit” është një manifestim që identifikohet me Gjilanin, i cili njëkohësisht i dha identitet këtij qyteti. Sipas saj, vargut të pafund të luftëtarëve për liri i përkushtohet ky manifestim, i cili arriti një nivel të lartë kulturor dhe që tash e 32 vjet Gjilanin e bën kryeqytet kulturor të shqiptarëve.

Studiuesja Sabile Keçmezi-Basha, që është paraqitur me një studim të saj në këtë tryezë, ka theksuar se “Flaka e Janarit” nderon sakrificën e heronjve që ranë për liri që nga periudha e Skënderbeut e deri te lufta çlirimtare. Ajo pati një paraqitje kronologjike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore e këtej, duke u ndalur në të gjitha periudhat e rëndësishme që nga kërkesat për flamur e për republikë, vullnetin për liri dhe që pikërisht në këto kohë “Flaka e Janarit” nisi rrugëtimin e saj, pikërisht në kohën e suprimimit të autonomisë së Kosovës e në mungesë të lirisë.



Ajo tha se në vitet '90 nga pushtuesi tentohej të shkatërrohej çdo aspekt i jetës në Kosovë, pati dhunë, arrestime e vrasje e “Flaka e Janarit” ishte një formë e rezistencës ndaj pushtuesit. Keçmezi-Basha tha se me këtë manifestim u nderuan heronjtë, dëshmorët, me të u bë thirrje për bashkim e fuqizim e populli u përgatit për ditët që po vinin. “Flaka e Janarit” ishte një organizim që tmerroi armikun dhe megjithëse u tentua që ajo të pengohej, ‘Flaka...’ pati një shpërthim edhe më të vullshëm, andaj ajo zë një vend meritore në historinë e Kosovës”, ka deklaruar Keçmezi-Basha.

Shensi Sylja, zëvendësministër i Mbrojtjes dhe një nga nismëtarët e “Flakës së Janarit”, tha se ky manifestim mbajti gjallë idealin për liri. Duke rikujtuar nismat e para për krijimin e këtij manifestimi, Sylja tha se

ishin kohë të vështira, kohë okupimi klasik, por që nismëtarët nuk u ndalën, të frymëzuar nga heroizmi i Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës e i heronjve të tjerë. Foli se si emërtimin “Flaka e Janarit” e kishte propozuar Hydajet Hyseni, si u rindërtua miniteatri në Bresalc, si u vazhdua me manifestim në Përlepnice e më pas edhe në Gjilan, duke shtuar se “Flaka e Janarit” kishte për qëllim mbajtjen gjallë të luftës për çlirim.

Studiuesi Ilir Vokshi është paraqitur me një kumtesë mbi “Represionin serb pas vitit 1981”, duke thënë se vetëm në Prishtinë, pas demonstratave të vitit 1981, patë nëntë të vrarë dhe 15 të plagosur. Ai përmendi edhe kërkesat e kësaj demonstrate, që në qendër kishin kërkesën për Kosovën Republikë, foli edhe për mijëra vjet burgim për

demonstruesit, për përjashtimet nga puna, institucionet arsimore, por edhe vazhdimin e luftës për liri, duke u formuar një numër i madh i organizatave të fshehta.

Albin Halimi në kumtesën e tij është ndalur te jeta dhe vepra e Kadri Zekës. Ai ka folur për aktivitetin e Kadri Zekës në grupin revolucionar të Kosovës, për qëllimet atdhetare të tij dhe të shkove të tij, për botimin e gazetës “Liria” në Zvicër, për bashkëpunimin me vëllezërit Gërvalla, për mbajtjen e lidhjes së fuqishme me përfaqësuesit e Shqipërisë dhe për veprimtarinë e Kadri Zekës gjatë e pas demonstratave të vitit 1981 deri në rënien heroike më 17 janar 1982.

Studiuesi Sefedin Halimi, duke folur për veprimtarinë atdhetare të Rexhep Malës, tha se ai ishte pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1968. Foli

për largimin nga vendi, arrestimin e tij, qëndrimin burrëror në burg dhe lirimin në vitin 1983 ku, përkundër kësaj, nuk e ndali aktivitetin atdhetar dhe nuk u dorëzua kurrë. “Për Rexhep Malën çlirimi dhe bashkimi kombëtar ishte ideal mbi të gjitha idealet”, tha ky studiues. Për veprimtarinë e Nuhi Berishës, e një kumtesë është paraqitur studiuesi Rexhep Arifi, i cili ka paraqitur fragmente kujtimesh për këtë atdhetar. Ai tha se Nuhi Berisha që nga mosha e re iu bashkua lëvizjeve ilegale dhe se ai pati aftësi të jashtëzakonshme komunikuese. Ishte njeri i sakrificave, shkruante parulla e shpërndante trakte. Sipas Arifit, Nuhi Berisha ishte organizator i formacioneve të para stërvitore për luftën e armatosur. Ai rrugëtoi me Rexhep Malën deri në rënien heroike në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë.

PDK-ja dhe lideri i saj i japin mbështetje lulëkuqes që të jetë simbol i përkujtimit të gjenocidit



PRISHTINË, 15 JANAR - Në Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i ka dhënë mbështetje “Lulëkuqes së Kosovës” si simbol i përkujtimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë, të propozuar nga Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”. “Në këtë përvjetor të dhembjes dhe kujtesës sonë kombëtare kërkojmë zbatimin e Rezolutës për gjenocidin e kryer serb në Kosovë, të miratuar më 16 maj të vitit 2019 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sipas kësaj Rezolutive, ne kërkojmë që shteti i Serbisë, ndër të

tjera, të pranojë se ka kryer gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës në Kosovë dhe, në të njëjtën kohë, përmes masave në nivel kombëtar dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, t'i ndëshkojë ata që kanë planifikuar, kryer apo nxitur gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë”, ka shkruar Krasniqi në “Facaebok”. Ai ka thënë se mbi 12 mijë persona të vrarë, prej tyre mbi 1 300 fëmijë, viktima të qindra masakrave, mbi 20 mijë vajza dhe gra të dhunuara, mbi 1 600 persona të zhdukur me dhunë dhe një popull i tërë kërkojnë drejtësi.

Maqedoni e Veriut, pagë minimale për shpenzime maksimale

SHKUP, 15 JANAR - Paga minimale në Maqedoninë e Veriut do të rritet nga 18 000 në 20 000 denarë (nga 292 në 325 euro), ka njoftuar Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Rritja e pagës minimale prej 11-përqindësh do të nisë të aplikohet nga muaji mars, ndërsa do të ketë edhe rritje të pensioneve, bëjnë me dije nga Ministria e Punës, duke paralajmëruar se rritje do të ketë çdo vit bazuar në metodologjinë e re për llogaritjen e pagës minimale konform rritjes së pagës mesatare dhe inflacionit. Sipas institucioneve, me këtë metodologji të re do të rritet edhe standardi i qytetarëve pavarësisht prej rritjes së madhe të çmimeve dhe inflacionit që ka shkuar mbi 20 për qind. Por, qytetarët thonë se kriza ekonomike dhe rritja e çmimeve ka goditur aq rëndë standardin e tyre sa që kjo rritje fare nuk do të vërehet në nevojat e tyre të përditshme. “Vetëm për energji elektrike paguaj 5 000 denarë (afër 100 euro). Për një familje shpenzimet arrijnë 600-700 euro, ndërsa rroga është 300 euro. Këtu nuk ka asnjë perspektivë. Kjo ka bërë që të rinjtë të ikin jashtë. Çmimet këtu janë sikur në Gjermani, atje rroga është 2 000 euro, kurse te ne 300 deri 400 euro, prandaj kemi largim nga vendi sepse s’ka të ardhme”, thotë Skënder Osmani, punëtor në një ndërmarrje tregtare. “Shporta e konsumit është rritur, janë rritur edhe çmimet e



ushqimeve, duke nisur që nga gjërat më të nevojshme për një familje. Këtu nuk po përmendi ato shpenzimet e luksit pasi ne kemi probleme me gjërat elementare për ekzistencën e një familjeje. Qeveria është ajo që merret me politikat fiskale dhe duhet të determinohen me rregullimin e çmimeve. Duhet të stimulohen ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme, por edhe familjet në nevojë, qoftë me uljen e çmimeve, të energjisë elektrike apo të TVSh-së”, thotë Nexhat Selmani, mësimsdhënës në arsimin fillor. “Paga minimale nuk duhet të jetë më e ulët se 40

000 denarë (rreth 600 euro). Çfarë do të bëjmë me 20 000 denarë? Nuk arrijmë të blejmë as ilaçet. Nuk arrijmë t’i shlyejmë as faturat për ujin dhe energjinë elektrike”, thotë Stevo Pandov, pensionist. “Mendoj se paga minimale duhet së paku të jetë 30 000 denarë (rreth 500 euro) pasi nga marketi nuk mund të dalësh pa shpenzuar në ditë të paktën 500 denarë (rreth 10 euro). Me ato që mbeten duhen paguar faturat, ilaçet e për gjëra të tjera as që mendojmë”, thotë Svetlana, e punësuar në një fabrikë tekstili. Megjithatë, se si do të ndikojë

rritja e pagës minimale me 11 për qind dhe nëse mund të çojë në shkurtime të vendeve të punës, mbetet për t’u parë, thonë nga Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë së Veriut (LSM). Por, sipas LSM-së, rritja e paralajmëruar nuk mund të mbulojë as për së afërmi koston bazë të jetesës. “Paga minimale, sipas rregullave të reja bazuar në Ligjin për Pagën Minimale, sipas përlogaritjeve tona të bazuara në të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave dhe Bankës Popullore, do të rritet 20 098 denarë. Dhe nëse e shikojmë përmes shportës minimale të

sindikates do të jetë sërish shumë e ulët. Nuk do të mjaftojnë aspak për të siguruar ushqim dhe pije për një familje”, thuhet në një komunikatë të Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë së Veriut.

Paga minimale përcaktohet sipas pagës mesatare dhe në Maqedoninë e Veriut ajo arrin 54.37 për qind të saj. Paga mesatare ka arritur në 33 000 denarë apo rreth 550 euro, ndërkohë që shporta e konsumit për një familje me katër anëtarë arrin në 51 200 denarë (832 euro). “Rritja e pagës minimale nuk do të shkaktojë goditje në ekonomi”, konsideron Angel Dimitrov nga Organizata e Punëdhënësve. Por, sipas tij, Bashkimi Evropian ka miratuar një rekomandim, me të cilin paga minimale në vendet anëtare duhet të jetë rreth 50 për qind e mesatares. Dimitrovi thotë se kjo nënkupton se Maqedonia e Veriut ka një përqindje më të lartë të pagës minimale krahasuar me vendet anëtare të BE-së.

Nga Lidhja e Sindikatave druajnë se rritja e pagës minimale mund të ketë pasojë ndaj punëtorëve, në veçanti në sektorin e tekstilit, pasi në këtë degë të ekonomisë pagat janë më të ulëta, andaj edhe punëdhënësit mund të përdorin metoda të ndryshme për të mos i paguar punonjësit me rritjen e re të pagës minimale që pritet të hyjë në fuqi pas një muaji.

Pritet të hapen 300 vende të reja të punës

PRISHTINË, 15 JANAR - Në emër të Komisionit Ndërmarrës për Investime Strategjike, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka nënshkruar marrëveshjen për realizimin e projektit strategjik me pronarin e subjektit “Kosmonte Foods”, Lulzim Begaj.

Kjo marrëveshje ka për qëllim realizimin e projektit strategjik në vlerë totale prej 11,143,917.2 eurosh (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë euro e njëzet centë).

Sipas marrëveshjes, investimi do të kryhet së shpejti dhe do ta jetësojë projektin investues duke sjellë dhe bashkëpunuar me kompaninë gjermane “Zott” dhe kompaninë sllovene “Perutnina Ptuj”.

Nga ky projekt strategjik parashihet të hapen së paku edhe 300 vende të reja pune. Objekt i kësaj marrëveshjeje është dhënia në shfrytëzim e pronës për 99 vjet në zonën

kadastrale Harilaq, komuna e Fushë-Kosovës, e cila do të shfrytëzohet për investime strategjike në asete fizike për grumbullimin, trajtimin, ruajtjen e pemëve dhe perimeve, përpunimin e tyre dhe tregtimin e produkteve bujqësore si dhe përpunimin e mishit të shpezëve.

“Perutnina Ptuj” pritet sivjet të fillojë investimin në fabrikë dhe vendosjen e mbarështimit të zogjve të pulës.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është realizimi i projektit strategjik dhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve përmes Autoritetit Kontraktues dhe Investitorit për implementimin e projektit strategjik të fituar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Marrëveshja u nënshkrua në fund të vitit të kaluar dhe i hap rrugë zbatimit të investimit strategjik i cili pritet të fillojë së shpejti.



Lufta s'ka përfunduar, por si të fitojmë sërish?

Serbia dukshëm synon ta pengojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me Kosovën e të në cilën domosdoshmërisht do të pranonte se Kosova ekziston si shtet dhe jashtë juridiksionit të saj. Këtë synim dëshiron ta realizojë përmes Kosovës dhe duke fajësuar këtë. Duke tentuar t'i fshehë duart nga zjarri, porse duke i fryrë atij hapur, Serbia dëshiron që t'i aplaudojë secilit veprim jo krejtësisht të matshëm me indikatorë suksesi të Kosovës. Sikurse që në disa raste Kosova u fut dhe mbeti në rrethin për të cilin as në ëndërr nuk do ta dëshironte. Serbia po ngrit në ajër aeroplanët e vet luftarakë, ndërsa bashkësia ndërkombëtare demokratike po kërkon që "palët të përmbahen nga veprimet provokuese e unilaterale". Dorën në zemër, deklarimet e tilla të partnerëve tanë më shumë flasin për ngecjen tonë në argumentim, veprim e koordinim sesa për arritjet e Serbisë në luftën hibride



Nga Burim RAMADANI

Kosova nuk paraqet më "konflikt të ngrirë" derisa lufta realisht nuk ka përfunduar, por as nuk bën të kthejë veriun e saj në një gjendje të ngrirë. Investimi për të gjetur zgjidhje politike për marrëdhëniet midis shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë është dukshëm më i fokusuar në këtë vitin e fundit. Sot, shumë prej rasteve të njohura të konflikteve të ngrira – që për dekada me radhë kanë qenë të sponsorizuara nga Rusia - po "shkrihen" në rrjedhë dukshëm të shpejtë. Në veçanti pas tronditjes së merituar të Rusisë. Prandaj, një "ngrijje e re e pjesshme territorialisht" do t'i përshtatej Rusisë së thyer këmbësh, por me butonë të kuq afër dorësh.

Në lëshim eventual të momentumit ndërkombëtar e euro-atlantik, ideja e "Luftës" dhe ideja "Ngrijje veriun, shkrijë të tjerat" edhe mund të rikthehen si kërcënim real. Derisa lufta si kërcënim ka përgjigjen "ne mbrohemi bashkë me NATO-n", ideja e "ngrijjes së veriut" parandalohet me kujdesin dhe veprimet e përbashkëta në arritje të qëllimeve të përbashkëta.

Lufta parandalohet e fitohet me NATO-n dhe për NATO-n

Gjenerali James Mattis ka thënë: "Asnjë luftë nuk përfundon derisa armiku të thotë se përfundoi. Ju mund të mendoni se ka përfunduar, mund ta shpallni të përfunduar atë, por në fakt, armiku e ka një votë aty". Dhe, është krejtësisht e qartë se saherë që Serbia çon në ajër aeroplanët luftarakë - sado që shumicën e tyre të

lodhur i ka - ajo në të vërtetë është duke luajtur në "votën" e vet për mospërfundimin e luftës.

Kjo - jo që nuk është e njohur – duhet të argumentohet në secilin nivel të secilit shtet anëtar të NATO-s dhe BE-së, përmes një kampanje profesionalisht të përgatitur diplomatike të Kosovës, e që dorën në zemër është një prej sektorëve që ka mrizuar pakuptimshëm dhe kështu po dëmton momentumin e të vërtetës së Kosovës. Një model argumentimi i këtillë është dëshmuar i suksesshëm në aktivitetet informuese për planin e tranzicionit të FSK-së në mandat ushtarak, në vitin 2018.

Sido që të jetë, me apo pa aeroplanë efektiv të Serbisë në kufijtë verior të Kosovës, edhe parandalimi, edhe mbrojtja e Kosovës bazohet dukshëm në aftësinë tonë për të bashkëpunuar me NATO-n. Sikurse Sun -Tzu në "Arti i Luftës" para rreth 2500 vitesh ka thënë: "Arti i Luftës na mëson të mbështetemi jo në mundësinë që armiku nuk vjen, por në gatishmërinë tonë për ta prituri; jo në shansën që ai nuk na godet, por mbi faktin se kemi bërë pozicionet tona të pamposhtura". Pozicionet tona të pamposhtura janë me NATO-n. E për të përforcuar edhe më tutje parandalimin e luftës, këto pozicione të pamposhtura duhet të jenë edhe për NATO-n.

Se nuk mbrohemi vet, është politikë nacionale e sigurisë e normuar në dokumentin më të lartë të politikave të sigurisë. "Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial realizohet në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me praninë e trupave ushtarake ndërkombëtare të udhëhequra nga NATO-ja dhe me partnerët strategjikë të Kosovës." (Strategjia e Sigurisë së Kosovës, fq. 11 - miratuar më 25 tetor 2022).

Pra, vetëm dy muaj e gjysmë më parë, udhëheqja e Qeverisë dhe më pas edhe Kuvendi tha, ndër të tjera, se mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial realizohet në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me NATO-n dhe me partnerët strategjikë. Prandaj,

secila kërkesë publike për të thelluar koordinimin dhe bashkëpunimin e plotë është në vijë me këtë. Tek e fundit, është në vijë me të atë që Gjenerali Mattis i ka quajtur "fakte brutale".

Dhe, faktet brutale të Kosovës në këtë dimension përfshijnë pretendimin territorial të Serbisë, pavarësisht se Qeveria përmes Strategjisë së Sigurisë së Kosovës e ka vlerësuar si "të ulët" mundësinë e një sulmi konvencional ushtarak të Serbisë, porse ka identifikuar se Serbia e ka bërë të qartë qëllimin e saj për mundësinë e ndërhyrjes. (Strategjia e Sigurisë së Kosovës, fq. 7-8).

Prandaj, politika e sigurisë që "ne mbrohemi bashkë me NATO-n" duhet domosdoshmërisht të nënkuptojë që ne e dëshmojmë se ndajmë dhe promovojmë vlerat e njëjta dhe që sulmi ndaj nesh është sulm ndaj vlerave të promovuara nga NATO-ja. Dhe, sigurisht, ne nuk udhëzojmë NATO-n se si të interpretojë këto vlera. Edhe kur kjo nënkupton argumentimin rreth kërkesës së NATO-s "për t'u përmbajtur nga veprimet provokuese të të dy palëve". Dorën në zemër, deklarimet e tilla të partnerëve tanë më shumë flasin për ngecjen tonë në argumentim, veprim e koordinim sesa për arritjet e Serbisë në luftën hibride.

Tek e fundit, çështjen e veprimit të Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake (që udhëhiqet nga NATO) e kemi të kodifikuar në Kushtetutën e Kosovës. Në Nenin 153, ndër të tjera precizohet se "Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion të rishikojë, të pakësojë ose përndryshe të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen."

Të shmanget formula "Ngrijje veriun, shkrijë të tjerat"

Serbia, dukshëm, synon të pengojë çfarëdo mundësie të arritjes së një marrëveshje politike me Kosovën, e të në cilën domosdoshmërisht do të pranonte se Kosova ekziston si shtet dhe jashtë juridiksionit të saj. Jo që nuk e di këtë, por po lufton për ta minuar atë. Porse, Serbia këtë synim dëshiron ta realizojë përmes Kosovës dhe duke fajësuar këtë. Duke tentuar të fshehë duart nga zjarri, porse duke i fryrë atij hapur, Serbia dëshiron që të aplaudojë secilit veprim jo krejtësisht të matshëm me indikatorë suksesi të Kosovës. Sikurse që në disa raste Kosova u fut dhe mbeti në rrethin për të cilin as në ëndërr nuk do ta dëshironte. Serbia po ngrit në ajër aeroplanët e vet luftarakë, ndërsa bashkësia ndërkombëtare demokratike po kërkon që "palët të përmbahen nga veprimet provokuese e unilaterale".

TARGAT: Pavarësisht se vendimi ishte krejtësisht ligjor dhe i drejtë, Kosova as nuk hoqi targat ilegale të kohës së regjimit të Milloseviqit, as nuk arriti që t'i bindë apo detyrojë serbët lokalë në komunat veriore t'i ndërrojnë ato me targa të Kosovës, as nuk i siguroi ata që ta bëjnë këtë në rastet kur pranonin, as nuk ndëshkoi bartësit e këtyre targave ilegale dhe as ata që përdorën dhunë për të mos lejuar fqinjët e vet të ndërrojnë këto targa. Për më tutje, as nuk shtyu këtë vendim dhe as nuk e zbatoi. Thjesht, vendimi për targa është në gjendje të NGRIRË.

ZGJEDHJET LOKALE: Pas largimit të serbëve nga pozitat e zgjedhura në nivel komunal në veri, u vendos që zgjedhjet të mbahen më 18 dhjetor 2022. Pas "konsultimeve me parti politike" dhe "vlerësimit të institucioneve kompetente rreth situatës së sigurisë në veri të vendit" ato u zhvendosën për në datën 23 prill 2023. Dhe, se si funksionojnë këto komuna deri atëherë, por edhe më e rëndësishme a do të mbahen zgjedhjet më 23 prill 2023 apo edhe çka duhet të ndodh që ato të mbahen e të pranohen ndërkombëtarisht, do të presim të 'shkrihet' situata! Pra, zgjedhjet lokale realisht janë vendim me pikëpyetje dhe nëse nuk realizohet atëherë mund të kthehet në gjendje të NGRIRË.

POLICIA dhe RENDI PUBLIK: Largimi me motiv politik e etnik i serbëve lokalë të veriut nga Policia e Kosovës ka vënë limbo. As nuk ka policë atje që mund t'i ndihmojnë qytetarët halexhinj, as që të ndëshkojnë qytetarët problematikë në kundërvajtje, as të zbatojnë ligjin në raste penale, as të transferojnë një të

burgosur deri në Prishtinë, as të largojnë pengesat në rrugë dhe as të vendosin kontrolle patrulluese të rëndomta. Kështu, policët e dërguar në komunat tona në veri të vendit nuk arrijnë të kujdesen për rendin publik. Ndërsa, konkursi i hapur - sipas legjislacionit në fuqi - për policë të rinj, Kosovës i duhet të jetë i suksesshëm. Por, bazuar në pamundësitë e Kosovës në çështjen e targave dhe të zgjedhjeve lokale, atëherë edhe konkursi për policë të rinj mund të shihet si me pak indikacione suksesi në mungesë marrëveshjeje me partnerët fillimisht.

Kështu, aftësia reale e Policisë në komunat tona veriore është në gjendje të NGRIRË.

Formula alternative "Ngrijje veriun, shkrijë të tjerat" ishte përmendur edhe në faqen 24 në raportin nr. 206 të Grupit Ndërkombëtar të Krizave "Kosova dhe Serbia pas mendimit të GJND-së" të datës 26 gusht 2010, ku përpos kësaj për veriun ishin parashikuar tri opsione: plani i Ahtisaarit, autonomia e zgjeruar, ose shkëmbimi i territoreve.

Strategji pa taktika apo taktika pa strategji

"Strategjia pa taktika është rruga më e ngadaltë drejt fitores. Taktikat pa strategji është zhurma para humbjes", ka thënë Sun-Tzu tek "Arti i Luftës".

Kjo duhet të jetë e qartë për elitën institucionale, politike e shoqërore në Kosovë. Pra, nëse kemi një strategji vepruese me taktika të duhura për të mbuluar të gjitha mangësitë që na paraqiten në rrugën drejt realizimit të objektivave strategjike nacionale. Derisa, ndërhyrja e Serbisë përbrenda Kosovës është identifikuar dhe dëshmuar të jetë e madhe.

Në Strategjinë e Sigurisë së Kosovës, miratuar më 25 tetor 2022, në faqen 8 shprehimisht thuhet se "Ndërhyrja në çështjet e brendshme të Kosovës, nga shteti serb nëpërmjet ndikimit dhe instrumentalizimit të komunitetit serb, dhe veprimtarisë së strukturave ilegale të mbështetura nga shteti serb përqendrohet kryesisht në pjesën veriore të Kosovës. Integrimi jo i plotë i kësaj pjese të popullsisë është rezultat i qëllimeve jo-miqësore të Serbisë dhe tendencave të vazhdueshme të saj që të ndikojë në prishjen e marrëdhënieve ndëretnike".

Prandaj, strategjia jonë vepruese duhet që edhe të ndalojë qëllimet jo-miqësore të Serbisë, edhe të mos lejojë prishjen e marrëdhënieve ndëretnike, edhe të thellojë bashkëpunimin me NATO-n, edhe të parandalojë luftën, edhe të mos lejojë "ngrijjen e veriut".

Rritja e mediave sociale, kriza e së vërtetës, dhe kaosi i rendit të ri botëror



Nga Steven ERLANGER

Demokracia duket se është kudo nën sulm. Dhe ata që e sulmojnë variojnë nga populistët e zemëruar lokalë, tek autokratët që argumentojnë se pushteti i pakufizuar shtetëror prodhon më shumë përfitime për qytetarët e zakonshëm, dhe se demokracitë janë shumë të zhurmshme dhe të përcara për të bërë shumë mirë. Madje edhe brenda Bashkimit Evropian, sfidat reale ndaj demokracisë dhe shtetit të së drejtës po vijnë nga Polonia dhe Hungaria. Kjo e fundit cilësohet tashmë nga Parlamenti Evropian si një “demokraci e paplotë” dhe “një autokraci elektorale”. Fitorja e demokracisë liberale, të cilën Fresis Fukujama e kremtoi me të drejtë pas rënies së Bashkimit Sovjetik, mund të tingëllojë sot boshe. Ose është së paku nën kërcënimin e madh nga autokracitë, që variojnë nga Rusia në Kinë në Turqi, Brazil por edhe vendet e Gjirit të pasura me naftë. Sipas të dhënave nga “V-Dem Institute”, që monitoron demokracinë dhe variantet e saj, në fundin e viteve 1990 kishte 72 vende që po demokratizoheshin dhe vetëm 3 po rreshqisnin drejt një autoritarizmi më të madh. Vitin e kaluar, vetëm 15 vende po bëheshin më demokratike, ndërsa 33 po lëviznin në drejtimin e kundërt. Sipas “V-Dem”, demokracitë liberale janë në nivelin më të ulët në 25 vitet e fundit: Sot vetëm 13 për qind e popullsisë së botës jeton në vende që mund të përkufizohen si të tilla. Autokracitë absolute qeverisin mbi 26 për qind të popullsisë së botës, ndërsa “autokracitë elektorale” mbi

44 për qind të popullatës. Për këtë arsye “periudha unipolare” amerikane ka mbaruar prej kohësh. Dhe kaosi global në zhvillim do të jetë “kompleks, i fragmentuar dhe i rrjedhshëm, me ekstremet që do të tërhiqen nga aleancat oportuniste, paktet plurilaterale dhe kufijtë e mbivendosur” - shkroi Filip Stefëns, redaktor kontribues i “Financial Times”, në esenë e tij për Institutin Montenj. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre në NATO, janë seriozë në ndihmën që po i japin Ukrainës që të zbrapsë pushtimin rus, dhe e gjitha kjo paraqitet si një luftë e demokracisë kundër totalitarizmit. Por mund të ketë një keqkuptim rreth natyrës reale të kësaj lufte, dhe mund të jetë tejet optimiste pikëpamja që mund të ketë dikush për Ukrainën, vend që vetëm pak muaj më parë, vështirë se do të ishte marrë si një model demokracie apo transparence. Megjithatë, siç ndodh gjithmonë, politika ka nevojë për slogane dhe “demokracia kundër autoritarizmit” është një slogan që po marketohet shumë mirë. Por ky kontrast, i promovuar nga presidenti i SHBA-së Xho Bajden, është shumë i thjeshtë, pasi disa aleatë të NATO-s, si Hungaria dhe Turqia, si dhe pjesa më e madhe e Jugut global, përfshirë Indinë e madhe dhe kryesisht demokratike, kanë refuzuar që t'i bashkohen Perëndimit në vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë, dhe e shohin luftën në Ukrainë si një formë të luftës së deleguar midis SHBA-së dhe Rusisë. Dhe në dëshpërimin e tyre për energji dhe për të zëvendësuar naftën dhe gazin rus, demokracitë

perëndimore janë detyruar të afrohen me disa prej udhëheqësve më autokratikë të botës. Ndërsa Rusia dhe Kina po synojnë ta ndryshojnë apo edhe të shkatërrojnë rendin ndërkombëtar të ndërtuar nga fituesit demokratë të Luftës së Dytë Botërore, “konkurrenca gjeopolitike që ka vërtet rëndësi nuk është midis demokracive liberale dhe pjesës tjetër të botës, por mes shtetit ligjor dhe ligjit të më të fortëve” shkroi Stefëns. Në kuadrin e kësaj përballjeje, polarizimi i madh i demokracisë amerikane dhe dekadencia e saj janë faktorë të rëndësishëm, të cilët revolucioni dixhital po i bën të dukshëm në çdo cep të botës. “Tek e fundit, SHBA është pasqyra në të cilën ne shohim veten. Gjithçka që ndodh atje nuk kufizohet vetëm në Shtetet e Bashkuara, por analizohet dhe vëzhgohet në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës” - thotë Arança Gonzalez Laja, ish-Ministre e Jashtme e Spanjës, sot dekane e Shkollës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Paris në Sciences Po. Xhani Riota, profesor në Universitetin Princeton, i shton elemente të tjera këtij reflektimi. Në kushtet e trazirave ekonomike, pabarazive në rritje, erozionit të identitetit kombëtar të shkakuar nga globalizimi dhe shpërdorimit të përpjekjeve të mëdha ushtarake në Irak dhe Afganistan “Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimi e kanë humbur fuqinë e tyre të butë” thotë Riota. “Përpjekjet tona për të promovuar demokracinë në Lindjen e Mesme dhe Afganistan kanë dështuar. Për shumë njerëz në Perëndim, sidomos midis të rinjve,

demokracia është e rëndësishme, por po ashtu edhe klima dhe ekonomia” - shton ai. Por rënia e shpejtë e Amerikës nuk është domosdoshmërisht e dëshiruar edhe nga rivalja e saj kryesore strategjike dhe ideologjike, Kina. Ose, të paktën, jo menjëherë, siç e thekson edhe Huang Jing, politolog kinez-amerikan që jep mësim në Universitetin e Studimeve Ndërkombëtare të Shangait. “Në këto kohëra të trazuara, Kina është e interesuar për stabilitet” - tha Huang Jing në Forumin Ambroseti. “Kina dhe Rusia kanë një miqësi të pakufishme, por jo një aleancë me çdo kusht. Rusia ka një kapacitet të madh për të shkatërruar rendin aktual botëror. Ndërsa duke parë kaosin në Ukrainë, Kina po përpjeket të ruajë veten në rendin aktual dhe të luajë një rol paqë-bërës që kontribuon për të mirën e përbashkët. Një rënie kaotike e SHBA-së është katastrofike për ne dhe për ekonominë globale. Kina beson se një SHBA e qëndrueshme, kohezive dhe e begatë është e mirë për Kinën, të paktën tani për tani” - thekson ai. Ndërkohë Bruno Lë Mer, Ministri francez i Ekonomisë, Financave dhe Sovranitetit Industrial dhe Dixhital, thotë se dixhitalizimi i hapësirës politike dhe konfuzioni midis së vërtetës dhe gënjeshtërisë e kanë dobësuar shumë demokracinë. “Revolucioni dixhital ka ndryshuar jo vetëm organizimin e kombeve dhe shoqërive tona, por edhe trurin tonë. Nuk mund të ketë demokraci pa një hapësirë të përbashkët për debat. Dhe cili është rezultati i një debati politik? Shumica e njerëzve

e gjejnë veten rreth të vërtetave të përbashkëta, vëzhgimeve të përbashkëta, diagnozave të përbashkëta. Por në epokën e revolucionit dixhital nuk ka asgjë të tillë” - deklaroi ai gjatë një interviste. Për të mediat sociale janë “një univers mendor i ndryshëm, ku nuk ka një të vërtetë të vetme” ndërsa “në themelin e demokracisë qëndron pikërisht dallimi midis të vërtetës dhe gënjeshtërisë”. “Dhe sot kjo është çështja më e rëndësishme politike, sepse demokracitë tona liberale janë dobësuar thellësisht nga revolucioni dixhital dhe individualizimi i shoqërisë” - argumenton Lë Mer. Edhe Bernard Spic, avokat dhe konsulent i Medef, shoqata më e madhe franceze e punëdhënësve, bie dakord se globalizimi dhe dixhitalizimi i kanë ndryshuar shoqëritë demokratike dhe si të gjitha revolucionet “mund të sjellin gjërat më të mira dhe ato më të këqija”. Por, e kombinuar me botën e re dixhitale të mediave sociale, ekziston një sfidë tjetër për demokracinë. Sot të rinjtë po kujdesen më shumë për ndryshimet klimatike, të cilat ata i shohin si një çështje ekzistenciale, sesa për demokracinë liberale, thotë Lë Mer. “Demokracia është punë e vështirë dhe ajo duhet të ushqehet çdo ditë” - thotë ish-ministrja spanjolle Laja. Dhe Riota shton se rreziku i vërtetë tani nuk është fashizmi: “Rreziku i vërtetë është lodhja nga demokracia”. Marrë me shkurtime nga Linkiesta - Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Krasniqi: Dua titullin dhe të shënojë sa më shumë gola për Clujn

PRISHTINË, 15 JANAR - Sulmuesi kosovar Ermal Krasniqi ka folur për herë të parë si lojtar i skuadrës rumune CFR Cluj. Ai debutoi me gol në ndeshjen e parë të tij me fanellën e kampionit rumun

dhe pas ndeshjes u shpreh shumë i lumtur për këtë. "Jam shumë i lumtur për golin dhe shpresoj që me këtë ritëm dhe këtë lojë të bukur të vazhdojmë edhe më tutje që ta ndihmoj ekipin

dhe objektivat e tij. Jam shumë i lumtur që kam ardhur ne Cluj dhe më kanë pritur shumë mirë si nga kryesia dhe të gjithë bashkëlojtarët. Shpresoj që të paraqitemi sa më mirë në

Ligën e Konferencës dhe pastaj edhe në ligë", ka thënë fillimisht Krasniqi. Ai më pas ka thënë se dëshiron të shpallet kampion me Ckuj dhe të shënojë sa më shumë gola.



Bashkimi triumfon ndaj Rahovecit, Peja i kthehet fitoreve

PRIZREN, 15 JANAR - Bashkimi ka shënuar fitore shumë të rëndësishme, duke mundur Rahovecin me rezultat 78:68 (18:17, 23:9, 16:23, 21:19), në javën e 18-të të Prince Caffë Superligës. Në çerekun e parë loja ishte tërësisht e barabartë, ku herë njëra e herë tjetra skuadër kalonte në epërsi, ndërsa përfundon 18:17 për prizrenasit. Edhe fillimi i periudhës së dytë ishte i barabartë, por më pas prizrenasit u shpallën fitorë me rezultat 41:26, plot 15 pikë diferencë. Megjithatë, Vreshtarët nuk u dorëzuan ku edhe pse në periodën e tretë ishin duke humbur me 17 pikë dallim, 53:36, arritën të gjejnë forcë dhe të ngushtojnë shifrat në 57:49, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Rahovecasit tentuan në dhjetë minutat e fundit të bëjnë përmbyshjen e madhe, por nuk ia arritën qëllimit dhe pësuan 78:68. Te Bashkimi u dallua Courtis Jones me 21 pikë e pesë kërcime, kurse te Rahoveci më i miri ishte Michael Green me 15 pikë e tri kërcime. Prizrenasit kanë tetë fitore e dhjetë humbje, kurse

rahovecasit kanë dy fitore e 15 humbje. KB Peja ka shënuar fitore ndaj Vëllaznimit në udhëtim me rezultat 57:81 (15:15, 16:23, 15:18, 11:28), në xhiron e 18-të të Prince Caffë Superligës së Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte i barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte shpërndarjen duke përfunduar kjo pjesë 15:15. Edhe periudha e dytë ishte kryesisht e barabartë deri në tre minutat e fundit të kësaj pjese, kur verdhezinjtë me një seri prej 0:9, shkruan në pushim mes pjesëve 31:38. Në periudhën e tretë pejanët ishin më të mirë për një nuancë, duke e ngritur epërsinë, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 46:56. Në dhjetë minutat e fundit mysafirët vetëm sa e shtuan epërsinë dhe triumfuan 57:81, duke u kthyer te fitoret pas dy humbjeve radhazi. Te Vëllaznimi u dalluan Diamond Dod me dhjetë pikë e 14 kërcime dhe Atik Koshi me 11 pikë, ndërsa te Peja më i miri ishte Brad Waldow me 20 pikë e 18 kërcime. Kuqezinjtë kanë shtatë fitore e 11 humbje, kurse verdhezinjtë 13 fitore e pesë humbje.



Barcelona fiton Superkupën e Spanjës



RIYADH, 15 JANAR - Barcelona është fituese e Superkupës së Spanjës pasi mundi në "King Fahd International Stadium" (Riyadh) ekipin e Real Madrid me shifrat 1-3. Një goditje e bukur me të majtën e Gavit i jep avantazhin katalanasve, të cilët mundën të festonin pas

gjysmë ore loje. Po Gavi jep një pasim për Lewandowskin në minutën e 45-të, me polakun që e ka të thjeshtë të realizojë golin e dytë. Me epërsinë e dyfishhtë, ekipi i Xavit e pati edhe më të lehtë në pjesën e dytë, ku mbylli llogaritë e takimit një herë e mirë 20

minuta para fundit me Pedrin. Asgjë për të thënë për "Los Blancos" në këtë takim, paraqitje tejet zhgënjyese, vetë një gol në fund nga Benzema dhe tanimë fokusi për djemtë e Ancelottit do jetë në kampionat dhe Ligën e Kampionëve.

Arsenali e fiton derbin ndaj Tottenhamit, 'blindon' vendin e parë

LONDËR, 15 JANAR - Arsenali ka arritur të shënojë fitore me rezultat të pastër 0-2 ndaj Tottenhamit, në kuadër të javës së 20-të në Premierligë. Një goditje e Sakas, nuk u ndal mirë nga

portieri Hugo Lloris, i cili e dërgoi topin në portën e vet për 0:1 në minutën e 14-të të ndeshjes. Epërsia u dyfishua në minutën e 36-të, kur Odegaard realizoi një gol të bukur nga distanca.

Në pjesën e dytë, Tottenhami e mori iniciativën dhe pati shumë raste shënimi, megjithatë portieri Ramsdale ishte në krye të detyrës. Me këtë fitore, Arsenali tani shkon

në kuotën e 47 pikëve, tetë më shumë se Manchester City. Në anën tjetër, Tottenhami mbetet i pesti me 33 pikë, pesë më pak se Manchester United dhe Newcastle.





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C.
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Neni 21, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative pika 15.3 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Rregulloren Nr.23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK SH.A dhe bazuar në Vendimin Nr.10/2022 të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së, me numër të protokollit 01-59/10, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli: Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar Korporativ

Numri i Referencës: ZP/KJ-1-2023

I raporton: Për punën e vet i përgjigjet BD

Niveli i pagës: Niveli II

Orët e Punës: 40 orë në javë

Mandati: 3 vite me mundësi vazhdimi.

Vendi i punës: KMDK SH.A, Zyra qendrore Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të parapara me Ligj, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe Kontratën e Punës;
- Mirëmbanë regjistrin e aksionarëve;
- Vepron si agjent i Kompanisë për pranimin e njoftimeve;
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetin përkatës siç mund të kërkohej me ligj ose me Statut;
- Koordinon me Bordin e Drejtorëve përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalet e secilës Mbledhje dhe mbledhjes së Përgjithshme të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetëve të Bordit dhe kujdeset që ato të jenë protokoluara;
- Kryen edhe detyra të tjera me kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv, në përputhje me Rregulloret e brendshme të Kompanisë;
- Kryen detyra të tjera shtesë sipas ligjeve në fuqi që ndërlihen me pozitën e caktuar;
- Për punën e vet i përgjigjet BD, ndërsa për punën e përditshme i përgjigjet KE-së.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik, në ligje;
- Përvojë pune së paku 3 vjeçare, e dëshmuar në fushën e legjislacionit.

Aftësitë kryesore:

- Të ketë aftësi të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Kompanisë.
- Të përmbushë kërkesat e parapara me Kodin e Etikës dhe praktikën e mira;
- Preferohet njohje e mirë e Gjuhës Angleze.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara: Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pika d, f, j, k, l dhe kanë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Me kusht që Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare.

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrën e KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrat e KMDK SH.A në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës "Shtjefën Gjeçovi"), "Lakrishtë". Tel: 038/ 600 – 552.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni,
- CV e detajuar (formati Europass),
- Kopja e letërnjoftimit ose Pasaportës me afat,
- Letër e Motivimit,
- Kopje e Diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për Diplomat e marra jashtë vendit;
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga Institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që e përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë Institucion);
- Deklarata nën Betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP-së e cila mund të shkarkohet web faqja e Kompanisë;
- Çertifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është tridhjetë (30) ditë kalendarike nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 16.01.2023 deri me datën 14.02.2023 ora 08:00-16:00h.

Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156
+386 49 848 553

PRISHTINË



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SHA
Kosovo Landfill Management Company J.S.C.
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU dd.

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima Član 21, na osnovu člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, na osnovu Etičkog kodeksa i tačke korporativnog upravljanja 15.3 za javna preduzeća, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK dd i na osnovu Odluke br. 10/2022 Upravnog odbora KMDK, sa protokolom broj 01-59 /10, Kompanija za upravljanje deponijama u Republici Kosovo saopštava sledeće:

JAVNI KONKURS (ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA)

Zvanje: Generalni savjetnik/korporativni sekretar
Referentni broj: ZP/KJ-1-2023

Izveštava: BD je odgovoran za svoj rad.

Nivo plate: nivo II

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Mandat: 3 godine sa mogućnošću produženja.

Mesto rada: KMDK SHA, Centralne kancelarije Priština

Dužnosti i odgovornosti:

- Predviđeno zakonom, Etičkim kodeksom i korporativnim upravljanjem javnih preduzeća, kao i Ugovorom o radu;
- Vodi registar akcionara;
- Deluje kao agent Kompanije za prijem obaveštenja;
- Vršiti sve podneske, publikacije i/ili objelodanjanja relevantnim organima u skladu sa zakonom ili Statutom;
- Koordinira sa Upravnim odborom pripremu pisama (dokumenata) za sastanke Upravni odbor;
- Vodi zapisnik sa svake sjednice i glavne skupštine Upravnog odbora, Direktore i komisije odbora i osigurava da se oni evidentiraju;
- Obavlja i druge poslove na zahtjev glavnog izvršnog direktora, u skladu sa internim aktima Društva;
- Obavlja i druge dodatne poslove u skladu sa važećim zakonima koji se odnose na postavljeno radno mjesto;
- BD je odgovoran za svoj rad, a EK je odgovoran za svakodnevni rad.

Kvalifikacije i radno iskustvo:

- Univerzitetska diploma Pravnog fakulteta;
- Radno iskustvo od najmanje 3 godine, dokazano u oblasti zakonodavstva.

Ključne vještine:

- Da posjeduje komunikacijske i saradničke vještine sa menadžmentom i osobljem Kompanije.
- Ispunjavanje zahtjeva predviđenih Etičkim kodeksom i dobrim praksama;
- Dobro poznavanje engleskog jezika je poželjno.

Zahtevani uslovi i kvalifikacije: Upravni odbor želi da obezbedi da svi potencijalni kandidati budu osobe poznatog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove prema članu 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačka d, f, j, k, l i (iii) imaju potrebno profesionalno iskustvo i obrazovanje potrebno za dotičnu poziciju. Pod uslovom (ii) da generalni savjetnik/korporativni sekretar poseduje univerzitetsku diplomu pravnika i značajno profesionalno iskustvo u oblasti korporativnog upravljanja ili prava kompanija.

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični obrazac u kancelariji KMDK SHA ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji u kancelarijama KMDK SA na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole "Shtjefën Gjeçovi"), "Lakrishtë". Telefon: 038/ 600 – 552.

Potrebna dokumentacija za prijavu:

- Aplikacija,
- Detaljan CV (Europass format),
- Kopija lične karte ili pasoša sa rokom,
- Motivaciono pismo,
- Kopija diploma o školskoj spremi, nostrifikacija za diplome stečene u inostranstvu;
- Dokaz o radnom iskustvu/uvjerenje o radnom stažu izdato od nadležnog zavoda za zapošljavanje, kojim se utvrđuje radno mjesto kao i trajanje angažovanja na toj poziciji;
- Izjave o penzijskim doprinosima (ne zahtevaju se za radno iskustvo pre osnivanja Kosovskog penzijskog štednog fonda i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili obavezni da plate ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa sajta Kompanije;
- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja);

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je trideset (30) kalendarskih dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 16.01.2023. do 14.02.2023. godine u 8:00 – 16:00 časova.

Napomene:

Kandidati sa nekompletnom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van konkursnog roka biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju definisane kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 552

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fjorijan Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shmu " 22 Dëshmorët " Randobrav.

- Naim Shala shpall te pavlefshme dëftesën e kl X shfm " Xhevat Berisha " Prizren.

- Naim Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Pranvera Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm " Fadil Hisari " Prizren.

- Jon Lcaj shpall te pavlefshme dëftesat enkl VI - IX shfm " Leke Dukagjini " Prizren.

- Besnik Sharani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Stina Guta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, TË SHM Teknike "Nexhmedin Nixha" rrobaqepëse.

- Sinaver Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Leutrim Shllaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari".

- Meriton Strojckaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Blenhard Malota nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomnë e sh.m. Teknike "Nexhmedin NIXHA".

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mishi pulë

cilësi e garantuar

pa konservues